VENDIM
Nr. 581, datë 17.7.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, DHE NR. 7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 95 130 (nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 të kreut III, ndryshohen si më poshtë vijon:

"1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 5 308 (pesë mijë e treqind e tetë) lekë.

Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit të jetë:

	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	57
Dega e sigurimit të barrë-lindjeve	1.4	266
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	4110
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	57
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	171
Sigurimet shëndetësore	3.4	647

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 332 (një mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë.

...

6. I vetëpunësuari, i vetëpunësuari në ortakëri, i vetëpunësuari që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuari, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.

...

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.8.2013 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 23 000 (njëzet e tre mijë) lekë.

...

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në muaj.".

3. Nënndarja "vi" e shkronjës "a" të pikës 1 të kreut VII, ndryshohet si më poshtë vijon:

"vi) Të dhënat mujore dhe progresive për detyrimet për kontributet e papaguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.".

4. Kreu VIII ndryshohet si më poshtë vijon:

"VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 12 024 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e katër) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma e përfitimit për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 27 të pikës 2 të nenit 59 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes të të ardhurave për barrë-lindje, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë gjatë gjithë muajve të vitit të fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12 muaj.

4. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërise", të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuara në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha